



DEPARTAMENTI

I TEKNOLOGJISË
DHE
INFORMACIONIT

BANKA E SHQIPËRISË

Gjatë viteve të fundit, Banka e Shqipërisë ka realizuar një shndërrim të madh lidhur me çështjet e teknologjisë së informacionit. Ky shndërrim konsiston si në zgjerimin e sistemeve të informacionit, rikonceptimin e sistemit të komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm, zgjerimin e burimeve njerëzore si dhe në zhvillimin e organizimit të tyre. Gjatë kësaj periudhe janë: (1) futur në funksionim një numër i mash sistemesh specifike (2) është krijuar një infrastrukturë e brendshme e mbështetur nga fjala e fundit e teknologjisë, (3) është krijuar dhe zgjeruar në mënyrë të vazhdueshme komunikimi elektronik bazuar në teknologjinë e postës elektronike (e-mail), "Internet" si dhe është krijuar dhe zhvilluar faqja WEB e Bankës së Shqipërisë; (4) është implementuar sistemi ATM dhe janë; (5) zgjeruar dhe rritur sistemet e sigurisë dhe të mbrojtjes së brendshme të informacionit.

Aktualisht, numri i kompjuterave personalë dhe përdoruesve të tyre, në vitet e fundit është rritur me 3 herë, numri punonjësve dhe i specialistëve të Teknologjisë së Informacionit është rritur 2.5 herë, numri i sistemeve është rritur me 10 herë, ndërkohë që investime të ngjashme janë kryer në infrastrukturën teknike.

Për të përballuar ritmet e rritjes dhe për të garantuar uljen dhe minimizimin e rreziqeve që lidhen me të, janë ndërmarrë një sërë masash. Si të tilla mund të përmendim: (1) miratimin e "Politikës së sigurisë së informacionit", (2) krijimin e Komitetit të Strategjisë së TI, (3) krijimin, brenda strukturës organizative të departamentit të pozicionit të "Administratorit të Projekteve", (4) krijimin e "Zyrës së Kontrollit dhe Sigurisë".

Projekti i Kontabilitetit dhe Operacioneve Monetare.

Projekti SARS.

Projekti i sistemit të sportelit të bonove të thesarit.

Projekti i realizimit të dhomës së dytë të kompjuterave.

Projekti i zhvillimit të Faqes së Bankës së Shqipërisë në internet (Home Pages).

Projekti i hartimit të Programit të Pagave.

Projekti i hartimit të Programit të Kleringut.

Projekti i instalimit dhe konfigurimit të Sistemit SWIFT.

Projekti i krijimit të Database për inventarizimin e pajisjeve informatike si dhe për evidentimin e difekteve.

Projekti i realizimit të lidhjes në internet të Bankës së Shqipërisë si dhe implementimi i sistemit të mbrojtjes FireWall.

Projekti i hartimit të programit për mbajtjen e kontabilitetit të Bankës së Shqipërisë.

Projekti i hartimit të programit mbi kreditë e punonjësve.

Projekti i realizimit të rrjetit informatik të Bankës së Shqipërisë si dhe shtrirja e tij në degë.

Projekti i automatizimit të zyrave.

Projekti i hartimit të programit të inventarit të Arkivës.

Projekti i hartimit të programit të burimeve njerëzore.

Strategjia Afatmesme e Teknologjisë së Informacionit

Banka e Shqipërisë është një institucion qendror dhe pa qëllim fitimi, me detyrat e saj kryesore të përcaktuara në ligj. Pozicioni qendror e vendos atë larg konkurrencës direkte, por megjithatë, nevojat e saj të zhvillimit kanë në bazë realizimin me eficiencë e efektivitet të detyrave ligjore, mbështetjen dhe mundësimin e vazhdueshëm të rritjes së sistemit bankar në Shqipëri. Në këtë kontekst, Banka e Shqipërisë kërkon të mbërrijë vizionin e mëposhtëm në fushën e Teknologjisë së Informacionit:

“Teknologjia e Informacionit do të mundësojë komunikimin e personelit, të klientëve dhe të publikut të Bankës së Shqipërisë, në çdo kohë, me mjetet dhe me informacionet e brendshme në mënyrë eficiente, të besueshme, të sigurtë.”

Për arritjen e vizionit në fushën e Teknologjisë së Informacionit, Banka e Shqipërisë identifikon katër objektiva kryesore si dhe projektet për realizimin e secilit prej tyre:

1. Përmirësimi/zhvillimi i njohurive dhe administrimi i informacionit:

Përmirësimi i shërbimit intranet/internet.
Përmirësimi i sistemit të postës elektronike.
Përmirësimi i aksesit dhe i shpërndarjes së të dhënave statistikore dhe financiare.
Regjistrimi dhe publikimi elektronik i informacioneve të Bankës së Shqipërisë.

2. Rritja e shkallës së sigurisë së informacionit, infrastrukturës mbështetëse si dhe e procesit të administrimit të saj:

Plotësimi i bazës rregullatore të nevojshme.
Lëvizja e sistemeve qendrore në një godinë të dytë.
Realizimi i auditimit të jashtëm periodik.
Përmirësimi i procedurave të administrimit të mjeteve (aseteve) të informacionit.
Trainimi dhe sensibilizimi i vazhdueshëm i punonjësve rreth çështjeve të sigurisë.

3. Përmirësimi dhe zhvillimi operacional:

Krijimi i “Help Desk”.
Implementimi i sistemit “RTGS”.
Implementimi i sistemit ACH.
Përmirësimi i komunikimit ndërbankar.
Implementimi i sistemit *Book Entry* për bonot e thesarit.

4. Forcimi dhe përmirësimi i komunikimit dhe i administrimit teknik.

Qendërzimi i administrimit të rrjetit.
Qendërzimi i administrimit të sistemeve operative si dhe përditësimi i tyre.
Realizimi i komunikimit të autentifikuar.
Rritja e qëndrueshmërisë, e kapacitetit dhe e besueshmërisë së rrjetit të brendshëm.
Implementimi i sistemit qendror të mbrojtjes nga viruset.
Zgjerimi i lidhjeve në distancë.

Zhvillimet e deritanishme në fushën e statistikës.

Pse banka qendrore ka rol thelbësor në mbledhjen e statistikave dhe pse zakonisht ka edhe rolin e shpallësit të parë të tyre? Përgjigja duhet kërkuar në rolin e saj si qendër e sistemit financiar të një vendi, si formuluese dhe zbatuese e politikës monetare, si dhe të mbikëqyrjes së sistemit financiar. Për të kryer si duhet funksionet e saj, ajo mbështetet në informacionin statistikor. Lidhjet e ngushta të bankës qendrore me sistemin financiar si dhe futja e saj në detajet e agregatëve të parasë dhe të kredisë, e bëjnë atë të ketë përparësi në drejtimin e përpilimit dhe të botimit të këtyre të dhënave. Banka qendrore mund të dërgojë të dhëna të nevojshme për llogaritë kombëtare ose statistika të tjera, në zyrat kombëtare të statistikave.

Në Bankën e Shqipërisë, bazuar në funksionet e saj si bankë qendrore, funksionojnë disa njësi që realizojnë përcaktimin e metodologjive si dhe punën konkrete për grumbullimin, kompilimin dhe shpërndarjen.

Njësitë statistikore në Bankën e Shqipërisë janë dy: **Spektori i Informacionit dhe Spektori i Statistikave të Bilancit të Pagesave dhe Vrojtiveve.**

Spektori i Informacionit është krijuar në tetor të vitit 1999. Qëllimet e këtij sektori janë:

- Përpunimi i statistikave monetare. Për këtë është ndërtuar sistemi raportues i bankave të nivelit të dytë. Këto informacione përpunohen për të paraqitur gjendjen monetare sipas udhëzuesve të statistikave monetare dhe bankare të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Statistikave Financiare Ndërkombëtare (IFS). Kjo paraqitje bëhet në bazë të metodikës dhe të Manualit të Statistikave Monetare dhe Financiare. Metodika hartohet në përputhje me standardet ndërkombëtare të përcaktuara nga institucionet financiare ndërkombëtare.
- Mbështetja në teknologji bashkëkohore për ruajtjen dhe përpunimin e këtij informacioni. Aktualisht, përpunimi i informacionit bëhet nëpërmjet sistemit SARS (Sistemi Automatik i Raportimit Statistikor).

Në planet e afërta të Spektorit të Informacionit është:

- Grumbullimi i informacioneve nga Shoqëritë e Kursim - Kreditit.
- Grumbullimi i informacioneve nga institucionet e tjera financiare.

Në këtë mënyrë do të krijohet një paraqitje e plotë e treguesve monetarë dhe financiarë.

Sektori i Bilancit të Pagesave dhe Vrojtimeve

Bilanci i Pagesave është një statistikë shumë e rëndësishme në pasqyrimin e sektorit të jashtëm të ekonomisë shqiptare.

Sektori i Bilancit të Pagesave ka këto funksione kryesore:

- Hartimi i Statistikave të Bilancit të Pagesave të Republikës së Shqipërisë, si një funksion i Bankës së Shqipërisë.

Statistikat e Bilancit të Pagesave përpilohen duke shfrytëzuar një numër shumë të madh burimesh informacioni dhe duke u mbështetur në Manualin e Fondit Monetar Ndërkombëtar (botimi i 5-të).

Të shtyrë nga natyra ekonomike e transaksioneve të caktuara, disa zëra në Bilancin tonë të Pagesave vlerësohen duke u bazuar me modele të hartuara nga Sektori.

- Analiza krahasuese mbi zhvillimet e ekonomisë shqiptare, në përgjithësi, me ato të ekonomive në tranzicion dhe ato në zhvillim.

Qëllimi i këtyre analizave është përshkrimi i zhvillimeve të sektorit të jashtëm të ekonomisë shqiptare si dhe faktorët shkak/pasojë që kanë ndikuar në këto zhvillime.

- Publikimi i Statistikave të Bilancit të Pagesave nëpërmjet pasqyrës së unifikuar të bilancit të pagesave, deklaratës për shtyp dhe Buletinit të Bilancit të Pagesave.

Qëllimi i këtyre publikimeve është përshkrimi i zhvillimeve të sektorit të jashtëm të ekonomisë shqiptare si dhe faktorët shkak/pasojë që kanë ndikuar në këto zhvillime.

- Kryen vrojtime statistikore për qëllime të statistikave të Bilancit të Pagesave. Të shtyrë nga natyra ekonomike e transaksioneve të caktuara, disa zëra në Bilancin tonë të Pagesave vlerësohen duke u bazuar në modele të hartuara nga Sektori. Por, këto vlerësime kanë nevojë të testohen dhe të përmirësohen. Për zëra të veçantë të bilancit të pagesave sektori kryen vrojtime dhe i përpunon rezultatet e tyre, të cilat përdoren si për llogaritjen e zërave të veçantë të Bilancit të Pagesave ashtu edhe për analiza kualitative për zhvillimin e ekonomisë në Shqipëri.

Objektivat kryesorë të Sektorit të Bilancit të Pagesave:

- Përmirësimi i statistikave të bilancit të pagesave.

Kjo ka të bëjë me rishqyrtimin e metodikave të vlerësimit të disa zërave të Bilancit të Pagesave kryesisht lidhur me llogaritjen e remitançave dhe të investimeve të huaja direkte.

- Hartimi i procedurave për llogaritjen e statistikave të Pozicionit Ndërkombëtar të Investimeve (sipas kërkesave të GDDS-it).
- Materiale studimore lidhur me zhvillimin e sektorit të jashtëm të ekonomisë.
- Rritja e numrit të publikimeve lidhur me statistikën e Bilancit të Pagesave dhe e vrojtimeve të kryera nga sektori.
- Rritja nga ana cilësore ashtu edhe sasiore e vrojtimeve qoftë lidhur me kërkesat e statistikave të bilancit të pagesave ashtu edhe me statistika të tjera.
- Përmirësimi i strukturës së Sektorit të Bilancit të Pagesave dhe Vrojtimeve.

Një moment i rëndësishëm në zhvillimin e statistikave në nivel kombëtar është përfshirja e Shqipërisë në Projektin e GDDS-it (General Data Dissemination Program) të FMN-së, së bashku me INSTAT dhe me Ministrinë e Financave. Qëllimi i projektit është rritja e transparencës dhe krijimi i standardeve të shpërndarjes së informacionit.